



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL
DHE KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
NË DREJTIMIN MËSIMOR “KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM PËR
NAFTË, GAZ DHE UJË”**

(Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²)

Kodi: X-II-22

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2024

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”**, Niveli II në KSHK, referuar Niveli II në KEK, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në të dy klasat e këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë testime të individëve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”**, Niveli II në KSHK, referuar Niveli II në KEK, është hartuar duke u mbështetur në programet e përgjithshme të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t'u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura për secilën prej tyre, janë si më poshtë.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Gjeologji e përgjithshme	53	25
2	Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit	82	38
3	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	80	37
	TOTALI	215	100

Temat sipas lëndëve janë:

1) Temat nga lënda “**Gjeologji e përgjithshme**”, kl. 10:

53 orë

Tema 2	Njohuri të përgjithshme për mineralet	10 orë
Tema 4	Njohuri të përgjithshme për shkëmbinjtë sedimentarë	7 orë
Tema 10	Proceset gjeologjike të jashtme (ekzogjene)	12 orë
Tema 11	Proceset gjeologjike të brendshme (endogjene)	12 orë
Tema 13	Njohuri mbi veçoritë gjeologjike gjatë shpimit të shtresës produktive	6 orë
Tema 14	Njohuri mbi veçoritë gjeologjike gjatë shfrytëzimit të vendburimeve të naftës	6 orë

2) Temat nga lënda “**Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit**”, kl.10 dhe kl.11:

82 orë

Tema 1	Llojet e puseve të shpimit dhe metodat e shpimit: ➤ Metodat e shpimit të puseve (klasike dhe eksperimentale)	4 orë
Tema 2	Sondat e shpimit, llojet dhe përbërja e tyre: ➤ Sondat e shpimit të puseve të naftës. Llojet e tyre.	5 orë
Tema 3	Kullat dhe Sistemi zhvendosjes vertikale në sondat e shpimit: ➤ Sistemi i zhvendosjes vertikale.	4 orë
Tema 4	Sistemi rrotullues dhe pompat e lëngut larës: ➤ Sistemi rrotullues qëllimi dhe funksionimi ➤ Pompat e lëngut larë, ndërtimi dhe funksionimi	(10 orë) 5 5
Tema 5	Kolonat e shpimit, funksionet, përbërja e tyre: ➤ Përbërja e kolonave të shpimit, funksionet	4 orë
Tema 6	Instrumentet shkëmbshkatërrues: ➤ Funksionet e instrumenteve shkëmbshkatërrues. ➤ Llojet e instrumenteve shkëmbshkatërrues.	(6 orë) 2 4
Tema 8	Lëngjet larës, funksionet, llojet e lëngjeve larës: ➤ Llojet e lëngjeve larës ➤ Përbërësit e lëngjeve larës	(10 orë) 2 4

	➤ Funkzionet e lëngjeve larës	4
Tema 1	Sistemi transmissiveve në sondat e shpimit të puseve: ➤ Funkzionet e transmissiveve në sondat e shpimit të puseve	3 orë
Tema 2	Agregatet energjetike: ➤ Funkzionet e agregateve të energjisë	4 orë
Tema 3	Pajisjet e grykës gjatë shpimit të puseve: ➤ Funkzionet e pajisjeve të grykës së puseve ➤ Ndërtimi dhe funksionimi manual dhe automatik i pajisjeve të grykës në shpimin e puseve ➤ Preventori dhe funksioni i tij (BOP);	(10 orë) 4 3 3
Tema 5	Kompleti karotier, ndërtimi, funksionimi: ➤ Funkzionet e kompletit karotier ➤ Krijimi dhe ruajtja e kampionit gjatë shpimit ➤ Analiza e kampionit në laborator	(9 orë) 3 3 3
Tema 6	Larja e pusit: ➤ Zgjedhja e llojit të lëngut larës për shpimin e shkëmbinjve	4 orë
Tema 7	Konstruksioni i pusit dhe tubimi: ➤ Konstruksioni i puseve dhe qëllimi i tij ➤ Llojet e kolonave të rrethimit në përbërje të konstruksionit	(6 orë) 3 3
Tema 8	Çimentimi i kolonave të rrethimit: Llojet e çimentimeve në puset e naftës, gazit dhe ujit	3 orë

3) Temat nga lënda “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, kl.10 dhe kl.11:

80 orë

Tema 1	Metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës: ➤ Shfrytëzimi i puseve të naftës me errupsion natyror ➤ Shfrytëzimi i puseve të naftës me errupsion artificial ➤ Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompë thellësie	(8 orë) 3 2 3
Tema 2	Vënia e puseve në shfrytëzim: ➤ Skema sipërfaqësore e pajisjeve të nevojshme për vënien e puseve në shfrytëzim	4 orë
Tema 3	Pajimi dhe konstruksioni i pusit: ➤ Kompletimi sipërfaqësor i grykës së pusit	4 orë
Tema 4	Përvetësimi i puseve të naftës e gazit: ➤ Përvetësimi me ulje niveli ➤ Përvetësimi me ajërizim ➤ Prova e kolonës në presion dhe hermecitet	(10 orë) 4 3 3
Tema 5	Teknologjia e shfrytëzimit të puseve të naftës me errupsion natyror: ➤ Përgatitja e pusit dhe operacionet përkatëse	4 orë
Tema 6	Kompletimi sipërfaqësor dhe nëntokësor i puseve me errupsion natyror: ➤ Kompletimi sipërfaqësor, armatura e grykës së pusit ➤ Kompletimi nëntokësor	(8 orë) 4 4

Tema 7	Teknologjia e shfrytëzimit të puseve të naftës me errupsion artificial: ➤ Përgatitja e pusit dhe pajisjet e shtytjes së ajrit	4 orë
Tema 8	Shfrytëzimi periodik i puseve me erupsion artificial: ➤ Shfrytëzimi me ngritës periodik dhe me presion	3 orë
Tema 1	Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompë thellësie: ➤ Pompat e thellësisë, klasifikimi dhe pjesët kryesore	5 orë
Tema 2	Sistemi pompë-lëkundës për nxjerrjen e naftës: ➤ Pajisjet e grykës së pusit	5 orë
Tema 4	Pajimi nëntokësor i puseve të nxjerrjes së naftës: ➤ Kolona e tubove të shfrytëzimit	3 orë
Tema 6	Metoda të tjera të shfrytëzimit të pusit me pompa pa purteka: ➤ Pompat me burmë	4 orë
Tema 8	Operacionet e riparimit të zakonshëm dhe kapital të puseve: ➤ Skemat e kompletimit të puseve dhe pajisjet me përdorim të përgjithshëm	4 orë
Tema 9	Grumbullimi, transporti i naftës dhe gazit: ➤ Nxjerrja e naftës dhe grumbullimi në grupin e prodhimit ➤ Transporti i naftës e gazit në grupe	(8) 4 4
Tema 10	Trajtimi i naftës dhe gazit: ➤ Trajtimi i thjeshtë i naftës e gazit në grupet e grumbullimit ➤ Përpunimi i naftës në stacionin qendror të grumbullimit përpara përpunimit në uzinë	(6 orë) 3 3

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 orë dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtete e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.)

Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
--------------------------	----------------------------	-----------------------------

Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...
--	--	---

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Gjeologji e përgjithshme	25	15	6	6	3
2	Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit	38	23	9	9	5
3	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	37	22	9	9	4
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitet e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitet me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitet me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit pikë-notë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, Niveli II në KSHK,

referuar niveli II në KEK, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr .	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryejë matjen e parametrave të naftës.	Detyra 1. Matja e parametrave të thjeshtë teknike në shpim dhe nxjerrje	15
2.	Të kryejë punime përgatitore dhe veprime praktike për vënien në punë të impianteve kryesore të sondës së shpimit	Detyra 2. Kryerja e punimeve përgatitore për vënien në punë të impianteve kryesore të sondës së shpimit.	20
3.	Të kryejë operacionet e punës për tubimin e pusit dhe përzgjedhjen e lëngut larës	Detyra 3. Kryerja e operacioneve të punës në shpimin dhe tubimin e pusit.	20
4.	Të kryejë operacionet kryesore të punës gjatë nxjerrjes së naftës.	Detyra 4: Kryerja (ndjekja) në terren e operacioneve të punës gjatë nxjerrjes së naftës.	20
5.	Të evidentojë rregullat e sigurisë në sondën e shpimit të puseve të naftës, gazit e ujit.	Detyra 5. Kushtet e punës dhe rregullat e sigurisë në sondën e shpimit të puseve të naftës, gazit e ujit.	10
6.	Të kryejë identifikimin e dukurive dhe proceseve gjeologjike në terren.	Detyra 6: Identifikimi i dukurive dhe proceseve gjeologjike.	15
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me **“detyra pune”**, në grupe pune (ose individuale), në mjedise reale sipërfaqësore të puseve për kërkim (nafte dhe gazi), shpim dhe shfrytëzim të ujit, por edhe në mjedise të simuluar (në pamundësi për ta realizuar në objekt, pus naftë, gazi) të udhëhequra nga mësuesi/instruktori ose një inxhinier/teknik i kompanisë në terren sepse rregullat e sigurimit teknik në puset e shpimit, nxjerrjes dhe shfrytëzimit të naftës, gazit e kanë të ndaluar rreptësisht hyrjen e nxënësve të Nivelit II.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Është e **domosdoshme dhe shumë e rëndësishme** që për çdo detyrë në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga organizatorët e provimit t’i kushtohet vëmendje **“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit dhe të ruajtjes së mjedisit”** gjatë gjithë kryerjes së detyrave dhe për çdo nxënës.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve, veglave të punës etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Në të gjitha detyrat mësimdhënësi i praktikës mund t’i grupojë nxënësit në grupe pune ku secili grup duhet ti kryejë të gjitha detyrat.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi përfundimtare.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.

Udhëzime për Detyrën 1. **“Matja e parametrave të thjeshtë teknikë në shpim dhe nxjerrje”**. Kjo detyrë nëse është e mundur duhet të kryhet në mjediset e një pusi naftë në terren të shoqëruar nga mësimdhënësi/një inxhinier apo teknik i kompanisë ose në pamundësi nxënësit ndjekin të gjitha proceset në formë simulimi në laborator.

Për realizimin e kësaj detyre nxënësi/grupet e punës kryen/kryejnë/ndjek/ndjekin veprime praktike për matjen e parametrave të thjeshtë teknikë në shpim dhe nxjerrje; kryen/kryejnë/ndjek/ndjekin veprime praktike për matjen e parametrave të naftës.

Për realizimin e kësaj detyre është e domosdoshme që mësimdhënësi t’u sigurojë nxënësve mjedise, vegla, pajisje dhe materialet si:

Zona të përshtatshme për t’u vizituar nga nxënësit, depozita, mjete transporti për vajtjen e nxënësve në terren (objekt), mjedise për sistemimin e tyre, fletore ose blloqe shënimesh,

stilolapsa, lapsa, goma, veshje të përshtatshme për ta si dhe kutinë e ndihmës së shpejtë me barnat më të domosdoshme për raste aksidentesh dhe sëmundjesh të lehta.

Kjo detyrë duhet të realizohet duke organizuar vizita mësimore në sondat e shpimit dhe në grupet e grumbullimit, ku kryhen dhe proceset e tjera që janë objekt i kësaj detyre. Para çdo vizite mësimdhënësi duhet t'ua bëjë të ditur nxënësve proceset dhe elementët që do vërtetojnë gjatë saj dhe çfarë do të bëjnë/kryejnë/ndjekin ata konkretisht. Nxënësit duhet të udhëzohen dhe të udhëhiqen nga mësimdhënësi për kryerjen drejt të vëzhgimeve dhe vizatimeve si dhe duhet të nxiten të diskutojnë me njëri-tjetrin për elementët dhe proceset e vërtetuara si dhe për interpretimin e rezultateve të vërtetimeve.

Instrumentet e vlerësimit që do të përdoren nga mësimdhënësi janë: vëzhgim me listë kontrolli dhe pyetje.

Nxënësi/grupet duhen të kryejnë/ndjekin procedurat e listuara më sipër nëpërmjet një bashkëbisedimi profesional dhe ky proces mbikëqyret gjatë gjithë kohës nga komisioni, i cili më pas mund t'i drejtojë pyetje të parapërgatitura për pikat kyçe të procesit.

Udhëzime për Detyrën 2. **“Të kryejë punime përgatitore dhe veprime praktike për vënien në punë të impianteve kryesore të sondës së shpimit”.**

Kjo detyrë nëse është e mundur, të kryhet në mjediset e një pusi naftë në terren të shoqëruar nga mësimdhënësi/një inxhinier apo teknik i kompanisë ose në pamundësi nxënësit ndjekin të gjitha proceset në formë simulimi në laborator.

Nxënësi në grupe pune kryen/ndjek procese të veprimeve përgatitore për fillimin e shpimit të pusit si dhe kryen/ndjek veprime praktike për vënien në punë të njërit prej impianteve kryesore të sondës së shpimit si: kontrolli fizik dhe teknik i impianteve kryesore të sondës së shpimit, vënien në punë të arganellos së shpimit, vënien në punë të rrotorit ose topdriverit, vënien në punë të pompave të lëngut larës, vënien në punë të impianteve të pastrimit të lëngut larës, vënien në punë të përzierësve të lëngut larës, vënien në funksionim të preventorit të fontanave si dhe vënien në punë të pajisjeve për përpunimin kimik të lëngut larës.

Kjo detyrë do të realizohet dhe do të trajtohet në mjediset e sondës së shpimit ose mësimdhënësi do të improvizojë situata të ngjashme me operacionet e përshkruara për këtë detyrë duke përdorur bazën materiale që është në sondën e shpimit dhe duke ju vënë në dispozicion nxënësve/grupeve sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të procedurave të punës për proceset e ndryshme gjatë shpimit të pusit.

Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen/ndjekjen e proceseve të ndryshme në sondë, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrtur nga mësimdhënësi dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës.

Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxëni.

Udhëzime për Detyrën 3: **“Kryerja e operacioneve të punës në shpimin dhe tubimin e pusit”.**

Edhe tek kjo detyrë nëse është e mundur duhet të kryhet në mjediset e një pusi naftë në terren të shoqëruar nga mësimdhënësi/një inxhinier apo teknik i kompanisë ose në pamundësi nxënësi ndjek të gjitha proceset në formë simulimi në laborator.

Për realizimin e kësaj detyre nxënësit/grupet e punës kryejnë/ndjekin veprime praktike për shtrësën e instrumentit të shpimit gjatë thellimit të pusit, kryejnë/ndjekin veprime praktike për ngritjen dhe uljen e instrumentit të shpimit për ndërrimin e daltës, kryejnë/ndjekin veprime praktike për pastrimin e shllamit dhe kontrollin e parametrave të lëngut larës, si dhe kryejnë/ndjekin veprime praktike për tubimin e pusit.

Edhe kjo detyrë do të realizohet dhe do të trajtohet në mjediset e sondës së shpimit ose mësuesi i praktikës do të improvizojë situata të ngjashme me operacionet e përshkruara në këtë detyrë (me simulim), duke përdorur bazën materiale që është në sondën e shpimit dhe duke ju vënë në dispozicion nxënësve/grupeve të punës sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për proceset e ndryshme gjatë shpimit të pusit -2.

Nxënësit/grupet e punës duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e proceseve të ndryshme në sondë, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur nga mësuesi dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës.

Instrumentet e vlerësimit që do të përdoren nga mësuesit, instruktorët janë: vëzhgim me listë kontrolli dhe pyetje.

Nxënësi/grupet e punës duhen të kryejnë/ndjekin procedurat e listuara më sipër nëpërmjet një bashkëbisedimi profesional dhe ky proces mbikëqyret gjatë gjithë kohës nga komisioni, i cili më pas mund t'i drejtojë pyetje të parapërgatitura për pikat kyçe të procesit.

Udhëzime për Detyrën 4. "Kryerja (ndjekja) në terren e operacioneve të punës gjatë nxjerrjes së naftës."

Kjo detyrë nëse është e mundur, duhet të kryhet në mjediset e një pusi naftë në terren të shoqëruar nga mësuesi/një inxhinier apo teknik i kompanisë ose në pamundësi nxënësi/grupi ndjek të gjitha proceset në formë simulimi.

Për realizimin e kësaj detyre nxënësi/grupet e punës kryen/kryejnë/ndjek/ndjekin veprime përgatitore për vënien e pusit të shpuar në punë. për nxjerrje naftë dhe kryen/kryejnë/ndjek/ndjekin veprime praktike për përvetësimin (shfrytëzimin) e pusit.

Organizatorët e provimit (mësuesi), (inxhinierët/teknikët) me proces simulimi (ose duke vërtetuar një pus të nxjerrjes së naftës në terren) iu kërkojnë nxënësve/grupeve të listojnë cilat janë veglat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e operacioneve të punës për nxjerrjen e naftës, si dhe të përcaktojnë radhën/hapat e kryerjes së proceseve të punës.

Gjithashtu nxënësit/grupet kryejnë/ndjekin me radhë proceset si (përcaktimi i ndodhjes së pajisjeve të injektimit të ajrit, përcaktimi i vendndodhjes së depove të naftës apo fluideve të tjerë /skemën bazë të lidhjes së tubove, depove dhe pajisjeve me grykën e pusit, përgatitjen e grykës së pusit dhe lidhjeve të nyjeve të injektimit, lidhjen e aparateve matës dhe kontrollin e presionit, debitit të fluidit të injektuar të nxjerrë nga pusi si dhe destinacionin e tyre etj).

Instrumentet e vlerësimit që do të përdoren nga mësuesit, instruktorët janë: vëzhgim me listë kontrolli dhe pyetje.

Nxënësi/grupet duhen të kryen/ndjekin procedurat e listuara më sipër nëpërmjet një bashkëbisedimi profesional, proces që mbikëqyret gjatë gjithë kohës nga komisioni, i cili më pas mund t'i drejtojë pyetje të parapërgatitura për pikat/hapat kyçe të procesit.

Udhëzime për Detyrën 5. "Kushtet e punës dhe rregullat e sigurisë në sondën e shpimit të puseve të naftës, gazit e ujit"

Edhe kjo detyrë nëse është e mundur duhet të kryhet në mjediset e një pusi për shpim dhe nxjerrje naftë në terren të shoqëruar nga mësuesi/një inxhinier apo teknik i kompanisë ose

në pamundësi nxënësi/grupet ndjek/ndjekin të gjitha proceset në formë simulimi. Nxënësit krijojnë pankarta me rregullat e sigurimit teknik në ambientet e bazës së praktikave profesionale.

Nxënësi/grupet e punës përshkruajnë kushtet e punës dhe rregullat e sigurisë në sondën e shpimit të puseve të naftës, gazit e ujit, në puset e nxjerrjes, grupet e grumbullimit, identifikojnë masat e parandalimit të aksidenteve, sistemet e hidrantëve për shuarjen e zjarreve si dhe kutinë e ndihmës së shpejtë.

Që të realizohet kjo detyrë nxënësve/grupeve të punës duhet të organizohet vizitë në sondat e shpimit dhe në puset në terren të cilave u kryhet remonti nëntokësor, dhe ku kryhen proceset e këtij remonti.

Gjithashtu nxënësve/grupeve të punës për realizimin e detyrës duhet t'u sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si mposhtë:

zona të përshtatshme për t'u vizituar nga nxënësit, mjete transporti vajtje e nxënësve në objekt, mjedise për sistemimin e nxënësve, fletore ose blloqe shënimesh, stilolapsa, lapsa, goma (të udhëzohen se si t'i mbajnë shënimet në fletore ose blloqe), veshje të përshtatshme për nxënësit, kutinë e ndihmës së shpejtë me barnat më të domosdoshme për raste aksidentesh dhe sëmudjesh të lehta etj.

Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë me njëri-tjetrin për elementët dhe proceset e vrojtuarra si dhe për interpretimin e rezultateve të vrojtimit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve (me listë kontrolli), duhet të vihet theksi te aftësia vëzhguese dhe interpretuese e tyre. Edhe kjo listë kontrolli mund të përmbajë kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

Udhëzime për Detyrën 6. **“Identifikimi i dukurive dhe proceseve gjeologjike”.**

Kjo detyrë do të realizohet në sipërfaqe të tokës, në terren ku aktualisht ndodhin dukuritë dhe proceset e përmendura: pranë vendeve ku parashikohet të hapen puse naftë, gazi dhe uji por edhe në zona të tjera ku potencialisht mund të ndodhin (hapen) ato. Nxënësit në mënyrë individuale ose në grupe pune bëjnë vëzhgimin, identifikimin, përshkrimin dhe interpretimin proceseve gjeologjike në terren dhe i hedhin ato në fletoret e tyre të punës.

Më pas, për të realizuar matjen gjeologjike, nxënësve mund t'u vihen në dispozicion dhe t'u sigurohet nga mësuesi: harta të ndryshme në letër, makete si dhe një busull gjeologjike. Mësuesi do t'i orientojë nxënësit të bëjnë matjen e elementeve të shtruarjes së shtresave. Për këtë, nxënësit duhet të përdorin busullën gjeologjike të kolauduar për të matur elementet e shtruarjes së shtresave dhe t'i hedhin matjet në fletore. Matjet duhet të përsëriten dy herë dhe të regjistrohet mesatarja e tyre në përfundim hidhen të dhënat në fletore. Vlerësimi do të realizohet me listë kontrolli duke vlerësuar çdo kompetencë.

Rekomandohet që secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vete dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara në 6 detyrat e punës, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse, sipas skemës së vlerësimit.